

FLEX 2000

NGJITËS RRËSHINOR I PERFORCUAR, ELASTIK, PËR PLLAKA (C2TES1)

Ngjitje e fortë për gjithë jetën

Përshkrimi i produktit:

Ngjitës i bardhë baze çimetore, pllakash të çdo lloji, me bazë çimento të bardhë "Portland" të rezistencës së lartë (I -52,5), i përforcuar me rrëshira polimeresh, inerte të përzgjedhura mermer të bardhë Dionisi dhe aditivë të posaçëm për përmirësimin e ngjitjes së pllakave në sipërfaqe të vështira dhe jopërthithëse, ku nevojitet ngjitje elastike dhe e fortë. Është faktuar veçanërisht rezistent në mjedise me lagështirë dhe me rezistencë të lartë ndaj ngricave.

Përdorimet:

Ngjitje të forta pllakash të çdo lloji, si p.sh.: qeramike, porcelanato, pllaka përthithjeje të ulët ose zero, mermeri dhe graniti, produktesh qelqi, çips, pllaka Karystosi dhe materialesh të tjera natyrore. Vendosija në çdo nënshtresë suvaje, betoni, porobetoni në dysheme ose mur, ambienti të brendshëm ose të jashtëm, edhe në dysheme me sistem ngrohës, xhakuzi, hamam, pishina. Për vendosje në kartonxhes duhet të lyhet më parë me astar akrilik uji MARMOLINE MST 11. Për vendosje në mozaikë, mermerë ose pllaka të vjetra, duhet të bëhet më parë lyerje e sipërfaqes me astar ngjitës MARMOLINE PRO CONTACT.



Avantazhet:

Ngjitje veçanërisht të forta me karakteristika elastike - Nuk vërehet rrëshqitje e pllakave gjatë vendosjes - Rezistencë e lartë ndaj luhatjeve të temperaturës (nxehhtë-ftohtë) dhe lagështisë - Cilësi e pakrahasueshme e lëndëve të para - Lehtësi vendosjeje - Punueshmëri e shkëlqyer - Përdorim i brendshëm dhe i jashtëm

Paketimi:

Thasë 25 kg. Paletë 1500 kg (60 thasë)
Qese plastike 5 kg. Paletë 960 kg (48 kuti kartoni me 20 kg)

Magazinimi:

Kohëzgjatja maksimale e ruajtjes në paketim të pahapur dhe mjedis të thatë: 12 muaj nga data e prodhimit

Siguria dhe higjiena:


Përmban kryesisht materialet e zakonshme të ndërtimit, çimento dhe inerte, rrjedhimisht nevojiten të njëjtat masa të ruajtjes që vlejnjë për përdorimin e materialeve të mësipërme.

Standardet:

EN 12004 (C2TES1)

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

Ngjyra:	I bardhë
Rezistenca ndaj shqitjes:	
<i>Vlerat mesatare të kontrollit të kualitetit të prodhimit:</i>	
Në beton pas 28 ditësh:	1,8 N/mm ² (EN 1348)
Pas ngrohjes në 70°C:	1,6 N/mm ² (EN 1348)
Pas njomjes:	1,6 N/mm ² (EN 1348)
Pas 25 cikleve ngrirje-shkrirjeje:	1,3 N/mm ² (EN 1348)
Rrëshqitja:	<0,5 mm (EN 1308)
Deformimi tërthor:	4,0 mm (EN 12002)
Koha e vendosjes pas hapjes:	30 - 40 minuta
Koha e korigjimeve të vogla:	10 minuta

 12 DoP: 006 MARMO-CPR
NORDIA S.A. 364 Kifissias Av., 15233 Chalandri, Athens/ Greece
EN 12004:2007+A1:2012 MARMOLINE FLEX 2000 Improved deformable cementitious adhesive for tiles with reduced slip and extended open time
Reaction to fire: <i>E</i> Initial tensile adhesion strength: $\geq 1.0 \text{ N/mm}^2$ Tensile adhesion strength after heat ageing: $\geq 1.0 \text{ N/mm}^2$ Tensile adhesion strength after water immersion: $\geq 1.0 \text{ N/mm}^2$ Tensile adhesion strength after freeze/thaw cycles: $\geq 1.0 \text{ N/mm}^2$ Transverse deformation: $> 2.5 \text{ mm}$ (class S1)

ZBATIMI:

- Uji për përzierje:** 7,0 kg (lt) ujë për një thes 25 kg
- Konsumi:** 2,5 - 4 kg/m², sipas njëtrajtësisë së sipërfaqes, madhësisë dhe lloji të pllakës
- Udhëzimet e përdorimit:**
- Kontrolloni që sipërfaqet të jenë të thata dhe pa pluhura, vajra dhe materiale të kalbura.
 - Nëse nënshtresa është e kalbur apo fërkohet, sugjerohet që sipërfaqja të lyhet me astar akrilik uji MARMOLINE MST 11
 - Trazoni mirë, me trapan elektrik me xhiro të ulët, një thes 25 kg me rreth 7 litra ujë të pastër.
 - Lëreni përzierjen të zërë për 5-10 minuta dhe trazojeni sërish
 - Përhapeni ngjitësin me ndihmën e një shpatulle të përshtatshme të dhëmbëzuar (madhësinë e së cilës duhet ta zgjidhni sipas nënshtresës dhe llojit të pllakës) njëtrajtshëm në të gjithë sipërfaqen e nënshtresës.
 - Përzierja e shtruar duhet të mbulohet me pllaka brenda 30 minutave pas shtrimit të kolës dhe sidomos përpara se të formohet kore (membranë) në sipërfaqen e saj.
 - Vendosini pllakat duke iu ushtruar trysni.
 - Ngjitësi mbetet i punueshëm në enë për 3-4 orë sipas stinës, temperaturës dhe lagështisë së mjedisit. Kur kola fillon të mpikset, duhet ta ripërzieni pa shtuar ujë.
 - Vendosja e pllakave mund të bëhet për 24 orë (për dysheme) dhe 12 orë (për mure).

KUJDES:

- Përmbajtja e qeses duhet të mbrohet nga lagështia
- Nuk këshillohet përdorimi në kushte ekstreme të mjedisit, si p.sh. ngrice apo vale të nxehti (temperatura e vendosjes: +5°C deri në +35°C)

Udhëzimet e përdorimit si më lart janë treguese për përdorimin e drejtë të produktit. Për hollësi të tjera dhe më të përpikta teknike mund t'i drejtoheni sektorit teknik të kompanisë.

Ne garantojmë cilësinë e produktit, për sa i përket specifikimeve teknike, siç këto printohen në deklaratën e performancës (CE) dhe në fletën teknike. Kjo garanci mbulon rreptësisht dhe vetëm produktin që ofrohet, dhe në asnjë rast rezultatin përfundimtar pas përdorimit të tij, i cili varet në shkallë të lartë nga përvoja dhe cilësia e punës së secilit përdorues, si dhe nga kushtet e përdorimit. Rekomandohet që përdoruesi ta përdorë një herë produktin në përmasa të vogla për provë dhe, pasi të sigurohet për rezultatin, të vijojë me punën e mirëfilltë. Botimi i fletës aktuale teknike anulon çdo botim të mëparshëm të saj.